



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
TREGTARE VLORE

Nr.45 Prot

Vlorë , më 06.09.2022

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËRDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të udhëzimit nr 14 datë, 27.05.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Ofruesi publik i AFP-së Shkolla Tregtare Vlorë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicione pune

Pozicioni 1:

DEGA - HOTELERI TURIZËM PËR PERSONELIN MËSIMËDHËNËS TË PRAKTIKES PROFESIONALE (me kohë të pjeseshme)

Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin e lire si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë përtë vepruar
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar

- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës ,sjeljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të praktikës profesionale në ofruesit e AFP-së si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesem, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional të AFP-së ,për të cilin /cilat po aplikon .
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën,në të cilën është kualifikuar.
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë: -

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g)- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) - vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) - vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) - vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

3. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës **14.09.2022**

DREJTORE
SHPRESA SALIAJ